REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 483/26 Dt. 21.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Vendimit 001-011 nr. 66126, të datës 02.06.2026 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRTIMIN DHE PROCEDIMIN E DOKUMENTACIONIT LIDHUR ME SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT URBAN

1. Selver Osmanaj-zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, caktohet zyrtar përgjegjës për administrimin dhe procedimin e dokumentacionit lidhur me subvencionimin e transportit urban në Komunën e Prizrenit.

2. Detyrat e personit përgjegjës janë:
   2.1. Të pranoj dhe kontrolloj faturat dhe dokumentacionin përcjellës të dorëzuar nga operatori,
   2.2. Të verifikoj përputhjen e faturave me kushtet dhe obligimet e përcaktuara në shpallje,
   2.3. Të kontrolloj raportet periodike të operatorit dhe dokumentacionin që dëshmon realizimin e shërbimit,
   2.4. Të verifikoj të dhënat relevante për llogaritjen e subvencionit në pajtim me metodologjinë dhe kriteret e përcaktuara në shpallje,
   2.5. Të evidentoj çdo mospërputhje ose mungesë të dokumentacionit dhe të kërkoj nga operatori plotësimin dhe korrigjimin e tij,
   2.6. Pas verifikimit të dokumentacionit, të përgatisë dhe procedoj dokumentacionin e nevojshëm për pagesë në njësinë kompetente të Komunës,
   2.7. Të mbaj evidencë të faturave, raporteve, dokumenteve përcjellëse dhe pagesave të proceduara,
   2.8. Të bashkëpunoj me Drejtoritë përkatëse, Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa dhe njësit tjera kompetente për çështjet që lidhen me realizimin e subvencionit,
   2.9. Të raportoj te drejtori i DSHP-së lidhur me gjendjen e dokumentacionit, faturat e pranuara, faturat e proceduara dhe çështjet eventuale që pengojnë procedimin e pagesave,
   2.10. Të kryej edhe detyra të tjera që lidhen me administrimin dhe procedimin e subvencionimit të transportit urban, sipas udhëzimeve të Drejtorisë dhe akteve përkatëse.

3. Me këtë vendim anulohet Vendimi 01 nr. 463/26, i datës 29.09.2026.

4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

5. Obligohet zyrtari i lartcekur, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe organet tjera kompetente, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



➢ Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurit,
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Organeve tjera kompetente,
- Arkivës së Kryetarit.